



Komuna Malishevë



NJOFTIM PUBLIK

SHQYRTIMI PUBLIK I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË MALISHEVËS

Të nderuar qytetarë,

Komuna e Malishevës ka kënaqësinë t'ju ftojë të merrni pjesë në **Shqyrtimin Publik të Planit Zhvillimor Komunal të Malishevës 2017-2025**.

Ky shqyrtim publik paraqet vazhdimësi të takimeve, prezantimeve e diskutimeve publike që janë zhvilluar përgjatë procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal. Si i tillë, ky shqyrtim publik është i hapur për qytetarët, shoqërinë civile, ekspertët, dhe të gjitha palët tjera të interesit për parashtrimin e komenteve, sugjerimeve dhe propozimeve, të cilat do të shqyrtohen para miratimit përfundimtar të Planit Zhvillimor Komunal të Malishevës.

Shqyrtimi Publik do të mbahet në periudhën 15 shtator - 15 tetor në ndërtesën e Komunës së Malishevës, ku do të jetë i prezantuar Plani Zhvillimor Komunal. Gjatë kësaj periudhe janë paraparë edhe pesë prezantime publike:

- Me 15.09.2016, ora 10:30, Malishevë- Ndërtesa e Kuvendit Komunal Malishevë
- Me 20.09.2016, ora 10:30, Kijevë - Shkolla e Mesme Profesionale "Lasgush Poradeci"
- Me 20.09.2016, ora 13:30, Panorc - Shkolla Filllore "Asim Vokshi"
- Me 21.09.2016, ora 10:30, Bellanicë - Shkolla Filllore "Ismail Qemajli"
- Me 21.09.2016, ora 13:30, Pagarushë - Shkolla Filllore "Vesel Pagarusha"

Në Planin Zhvillimor Komunal mund të qaseni edhe përmes *ueb faqes* së komunës, duke filluar prej datës 07.09.2016. Komentet, sugjerimet dhe propozimet mund t'i dërgoni në email adresen: pzhkmalisheve2016@gmail.com

Komuna e Malishevës është e përkushtuar të bashkëpunoj ngushtë me të gjitha palët e interesuara gjatë procesit të shqyrtimit publik të Planit Zhvillimor Komunal.

Pjesëmarrja juaj do të mundësoj përforcimin e bashkëpunimit në mes të **qytetarit** dhe **komunës**, duke ndikuar dhe kontribuar drejtpërsëdrejti në përmirësimin e jetës në komunën tuaj.

Ju mirëpresim!